

Data \_\_. \_\_. 2024

## PROCESVERBAL

### **PËR MOS-NDARJEN NË LOTE TË PROCEDURËS SË HAPUR MBI KUFIRIN E LARTË MONETAR**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:** *“Blerje materiale konsumi (implante ortopedike) për Shërbimin e ortopedisë në SUT” - Marrëveshje Kuadër me disa Operatorë Ekonomikë ku jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara, për një periudhë 24 mujore nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër*

*Fondi limit: 420,567,601 (katërqind e njëzetë milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e një) lekë pa TVSH ose fondi limit në Euro (sipas kursit të këmbimit nga BSH te datës 24.06.2024): 4,191,843 (katër milionë e njëqind e nëntëdhjetë e një mijë tetëqind e dyzetë e tre) Euro pa TVSH*

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 33183100-7  
Implante ortopedike**

Në bazë të nenit 39, pika 1, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c, autoriteti/enti kontraktor **Spitali Universitar i Traumës** ka hartuar procesverbalin për për mos-ndarjen në lote të procedurës së Hapur mbi kufirin e lartë monetar, me arsyetimin si më poshtë:

1. Procedura e prokurimit është një procedurë e ripërsëritur ndër vite dhe specifikimet teknike të materialeve ortopedike (implante ortopedike) janë të ndërthurura me njëra tjetrën pasi për një ndërhyrje kirurgjikale mund të përdoret një ose disa artikuj të cilat duhet të jenë të një marke të caktuar me setet përkatëse dhe specialistin e trajnuar që do të asistojë përgjatë operacioneve kirurgjikale.

2. Nga eksperiencia e Ak ndër vite, OE kontraktues kanë vënë në dispozicion të ekipeve mjeksore të SUT-së, setet në përdorim dhe personin e trajnuar për përdorimin e këtyre seteve. Kryerja e një operacioni kirurgjikal me materiale të ndryshme, sete të ndryshme dhe disa persona të ndryshëm të kualifikuar do të bënte të pamundur ndërhyrjet kirurgjikale.

3. Ndarja në lote do të krijonte konfuzion tek OE pjesmarrës dhe kosto shtesë për AK në kryerjen procedurave të prokurimit dhe në zbatimin e kontratave të furnizimit me implante ortopedike.

**Njësia e Prokurimit:**